



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10 të Ligjit nr. 04/L –144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20 të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **a** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2019, merr këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
POLICISË SË KOSOVËS

- I.** MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Policisë së Kosovës, pa procedurë të rregullt të konkurrimit.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 2890-7, me sipërfaqe prej 2880 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-02890-7, dhe parcela kadastrale nr. 2890-8, me sipërfaqe 201 m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-02890-8, Zona kadastrale Prishtinë, pasuri shoqërore, Kuvendi Komunal Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është ndërtimi i Stacionit policor “Jugu”.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, për 99 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.

IX. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- skicat grafike dhe
- kopja e planit dhe certifikata e pronësisë.

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0049045/19, më 01.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta